

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
479	22.03.2021	Kerkese per informacion per maternitetin Mbreteresha Geraldine .	07.04.2021	Ne vijim te kerkeses suaj: Ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin shoqerues. https://we.tl/t-jCYUKVsBvs 1. Shkresen Kthim pergjigje te skanuar; 2. Urdhrin e Ministrit Nr. 122, datë 05.03.2007; 3. Kartelën e Pasurisë Kulturore “Materniteti në Bulevardin “Zogu i Parë”; 4. Vendim të KKTKM-së Nr. 29, datë 22.01.2020; 5. Link ne wetransfer per Projektin e miratuar për objektin “Materniteti në Bulevardin “Zogu i Parë”, të depozituar në Arkivën Teknike të IKTK-së.	E plote	JO
479/2	08.04.2021	Delegim Kerkese nga MK	08.04.2021	Ne përgjigje te kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Godina "Materniteti Mbretëresha Geraldinë" është pasuri kulturore me status "monument kulture kategoria e II-te", shpallur me Urdhër Ministri Nr. 122, date 05.3.2007 me emërtimin në listen e pasurive kulturore "Materniteti në Bulevardin "Zogu i Parë", si dhe ndodhet brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të Qendres Historike të qytetit të Tiranës, deklaruar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 582, date 03.10.2018. IKTK nuk disponon dokumentacion zyrtar nga Instituti i Ndërtimit per kryerjen e vlerësimit të gjendjes së godinës pas tërmetit. Projekti me objekt "Rikonstruksioni i godinave të Maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë" me subjekt aplikues Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, hartuar nga Instituti i Ndertimit është miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale Nr. 29, date 22.01.2020. Ky projekt parashikon rindërtimin e shtesës së objektit nga krahu i bulevardit "Zogu i I" duke e integruar fasadën me objektin ekzistues me status "pasuri kulture" pa krijuar shpëtimje në vazhdimësinë e memories kolektive që gëzon ky objekt. Bashkëlidhur gjeni dosjen me dokumentacionin per pasurinë kulturore: Urdhrin e Ministrit Nr. 122, date 05.03.2007; Kartelën e Pasurisë Kulturore "Materniteti ne Bulevardin "Zogu i Parë" Vendim KKTKM-së Nr. 29, date 22.01.2020, Projektin e miratuar per objektin "Materniteti në Bulevardin "Zogu i Parë", të depozituar në Arkivën Teknike të IKTK-së.	E plote	JO
483	23.03.2021	Delegim Kerkese nga MK , lidhur me kërkesën për ndërhyrjet në objektin B.O.42 (2k) në qendrën e qytetit të Vlorës.	08.04.2021	Nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, me shkresë Nr.483/1 Prot., datë 02.04.2021, është marrë informacion se për objektin në fjalë (B.O.42) në fazën e parë janë realizuar vetëm disa punime që përfshijnë prishjen e mureve rrethuese të oborrit. Kërkojmë të merret në konsideratë përfshirja e realizimit të tërësisë së punimeve për objektin B.O.42 të parashikuara në projektin “Rikualifikimi në zonën e mbrojtur urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë” miratuar me vendim të KKR Nr. 60, datë 5.4.2017, gjatë zbatimit të fazës së II-të me objekt “Rikualifikimi Urban i Qendrës së Vlorës, Zona A” i cili është në proces shqyrtimi në organet vendimmarrëse. Bashkëlidhur gjeni shkresën Nr.483/1 Prot., datë 02.04.2021 dhe projektin për objektin B.O.42 në format elektronik.	E plote, deleguar per kompetence “FSHZH”	JO
484	23.03.2021	Percjellje Kerkese per projektin e ndertimit te godines se parkimit dhe hapësirave mbeshtetese ne Gjirokaster	15.04.2021	Në vijim të shkresës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Me anë të relacionit të hartuar nga DRTK Gjrokastrë, jemi informuar mbi gjetjet rastësore gjatë punimeve të ndërtimit të Parkimit Nëntokësor në sheshin “Çerçiz Topulli”. Në vijim, grupi i punës, i ngritur nga IKTK në bashkëpunim me DRTK Gjrokastrë, në datën 26.03.2021 kreu inspektimin në terren dhe konstatoi se objekti (pus i vjetër) ishte i mbuluar me inerte, duke e bërë të pamundur dokumentimin e tij. Sa më sipër, për të realizuar vlerësimin dhe dokumentimin e objektit të zbuluar, bazuar në pikën 2 të nenit 145, të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Ju duhet të ndëprisni punimet dhe të merrni masat për ta rikthyer atë në gjendjen e mëparshme. Pika 6 e Nenit 14 e VKM-së Nr. 619, datë 07.07.2015 “Për shpalljen “Qendër Historike” të një zone në qytetin e Gjrokastrës dhe miratimin e Rregullores për Mbrojtjen, Konservimin e Integruar dhe Administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur në qytetin e Gjrokastrës”, përcakton se:	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				<i>“Zbatimi i punimeve për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik kryhet prej DRTK-ve ose prej subjekteve të licencuara për restaurim dhe të licencuara në këtë kategori punimesh në fushën e ndërtimit, nën mbikëqyrjen e supervisorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IKTK-së dhe investitorit”.</i> Për këtë arsye, zbatimi i punimeve për objektin <i>“Ndërtimi i Godinës së Parkimit dhe Hapësirave mbështetëse në Gjirokastër”</i> duhet të kryhet nga subjekt i licencuar në fushën e restaurimit në kategorinë <i>“Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane, qendra historike”.</i> Gjithashtu, ju duhet të njoftoni IKTK-në për fillimin e punimeve me qëllim caktimin e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit.		
488	23.03.2021	Delegim Kerkese per projektin Plani i konservimit dhe nderhyrje perforcuese dhe restauruese te Kisha e Manastirit te Rubikut nga MK	01.04.2021	Ne vijim te kerkeses suaj ,Ju bëjme me dije se: Menjëherë pas tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si dhe të Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, u vunë në lëvizje për të inspektuar dhe për të evidentuar dëmet e shkaktuara prej tij në objektet Pasuri Kulturore. Nga raportimet në terren rezultoi se një prej objekteve që ishte cënuar nga termeti ishte edhe Kisha e Shën Mërise, në Rubik. Për këtë arsye Kisha e Shën Mërise në Rubik u përzgjedh në grupin e objekteve që kërkonin një vëmendje të vecantë e prioritare për tu trajtuar. Në zbatim të VKM Nr. 213, date 11.03.2020 “Për caktimin e IKTK si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, nisi procedura e Konkurrimit Publik me objekt: “Hartim Projekti “Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 4 objekte kulturi pasuri kulturore” (Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kurbin; Kisha e Manastirit të Rubikut, Mirditë; Ish Arqipeshkëvia e Durrësit në Delbnisht, Kurbin, Lezhë; Teja e Dollmës në Kalanë e Krujës)”. Për hartimin e Projektit të sipërcituar është lidhur kontrata e shërbimit me Nr. 1815 Prot., datë 09.10.2020 mes Autoritetit Kontraktor “Institut Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore” dhe Bashkimit të Operatorëve: "FOCUS Architecture" sh.p.k, "A V E Consulting" sh.p.k, "Comfort 96" sh.p.k, "AR-MI Projektim Mbikëqyrje" sh.p.k, "A.L.T.E.A. & Geostudio2000" sh.p.k, përfaqësuar nga Administratori Z. -, i "FOCUS Architecture" sh.p.k . Me Vendimin nr. 435, datë 16.12.2020 të KKTKM-së u miratua projekt ideja e objektit: ”Kisha e Manastirit të Rubikut, Mirditë”, dhe me Vendimin nr. 486, datë 16.12.2020 të KKTKM-së u miratua projekt zbatimi i objektit: ”Kisha e Manastirit të Rubikut, Mirditë”. 1.Informacioni i pergjithshëm për projektin e miratuar Qëllimi kryesor është hartimi i projekteve për stabilizimin, përforcimin dhe restaurimin e këtyre katër objekteve pasuri të trashëgimisë kulturore, me qëllim nxjerrjen e tyre nga gjendja e rrezikut si dhe identifikimin e shkallës së dëmtimit. Për të adresuar rreziqet e mundshme për njerëzit - punëtorët, vizitorët dhe ata në afërsi të sitit - dhe për të zvogëluar rrezikun e përkeqësimit të shpejtë dhe dëmtimit të strukturave të trashëgimisë në vend, objektivat e kësaj konsulence janë: ³/₄ Kryerja e studimeve, kërkimeve, inspektimeve në terren dhe rilevimeve të nevojshme përpara propozimit të ndërhyrjeve të nevojshme; ³/₄ Për të dhënë përparësi në opsionet paraprake të propozuara, duke marrë në konsideratë impaktin në vlerën e trashëgimisë, zbutjen e riskut, kostot dhe inputin e palëve të interesuara përkatëse; ³/₄ Të sigurojë projektin e detajuar për ndërhyrjet me prioritet të lartë të dakortësuara midis palëve të interesuara. 2. Ndërhyrjet restauruese të propozuara për kishën Ne projektin e miratuar propozohen të bëhen këto ndërhyrje: a) Hidroizolimi komplet i çatisë, kryesisht pjesa lindore mbi altar. Mbulesa duhet të jetë me material që nuk lejon depërtimin e ujit. b) Veshjet me gurë të fasades kryesore kanë nevojë për konsolidim, pastrim, fugatim dhe zëvendësimi i disa gurëve të dëmtuar. c) Restaurimi i dy kornizave kryesore prej guri, një në kallkanin e çatisë dhe tjetra në ndërkat, pastrim nga nxirja, injektim në bashkimet e shkëputura të gurëve. d) Parapeti i kallkanit me hark në pjesën e altarit ka dal jashtë përdorimit, duhet bërë izolim i ri dhe vendosje llamarine e re. Izolimi në këtë pjesë duhet bërë shumë korrekt, me të gjitha parametrat e duhura. e) Muri rrethues mbajtes i sheshit që rrethon kishën kërkon konsolidim në pjesët e rrezuara dhe kapuçim i kreut të murit gjatë gjithë perimetrit. f) Vlerësimi i konakëve të manastirit dhe ambientet ndihmese të tij. e) Hartimi i projektit elektrik e mekanik, etj sipas Termave të Referencës. <u>Konkretisht disa prej zërave që parashikohen në projektin e restaurimit janë:</u> a - Punime konservimi të muraturës ekzistuese:	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				³/₄ Pastrim nga bimësia e ulët e murit rrethues; ³/₄ Pastrim fasade nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqesore vetëm me ajër me presion (gurë, korniza, fuga); ³/₄ Lyerje në faqet e suvatuara me rezina mbrojtëse (mbyllje të mikrocarjeve të suvasë) dhe bojë vetpastruese; b - Restaurim të muraturës ekzistuese: ³/₄ Punime special, injektim carjesh me llac epoksid kompatibël me llacin ekzistues; ³/₄ Restaurimi i carjeve në mur guri me injektim (pastrim i carjes, injektim llac gelqere 1:3); ³/₄ Lyerje e fugaturave me rezina anticalcifikuese dhe antingrirje; ³/₄ Lyerje e gurëve të leskerizuarar me rezina anticalcifikuese dhe antingrirje; c- Punime meremetimi (mbrojtja ndaj lageshtirës): ³/₄ Shkepje gurësh trotuari ekzistuese; ³/₄ Shtresë betoni; ³/₄ Prishje betoni trotuari ekzistues; ³/₄ Meremetime catie (zëvendësim i tjegullave,ristelave binarëve të kalbur); ³/₄ Restaurim kornizash guri (vertikale dhe horizontale); ³/₄ Hidroizolim me emulsion dhe 2 d/bitum; ³/₄ Bërje trotuari (pllaka guri); ³/₄ Bordurë guri trotuari; ³/₄ F.V ulluqe vertikale dhe horizontale; d - Punime të ndryshme përforcimi: ³/₄ Prishje suvatim i jashtëm; ³/₄ Shkepje tavan i brendshëm druri; ³/₄ Heqje catie ekzistuese; ³/₄ Cati me tjegulla të ngjashme me të vjetrat; ³/₄ Punime speciale- injektim carjesh dhe qepje me gaxha; ³/₄ F.V fibra karboni (llac strutral + rezinë epoksidge + fibra karboni) për mure, qemere etj; ³/₄ Suvatim i jashtëm i zakonshëm; ³/₄ Shtangëzim horizontal në pjesën e mezaninës (heqje druri, f.v .strukturg horizontale celiku, rivendosje strukture druri +zëvendësim elementeve të dëmtuar të drurit) etj.		
505/1	25.03.2021	Kerkese per informacion per Mesonjetoren e Korces.	23.04.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Objekti “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” është pasuri kulturore me status monument kulture i kategorisë së I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973. Sa më sipër, në zbatim të pikës 1, të Nenit 77, të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, projekti me objekt “Rikonstruksioni i Muzeut Kombëtar të Arsimit, Korçë”, është shqyrtuar dhe miratuar nga KKR (sot KKTKM), me Vendim Nr. 233, datë 05.07.2019. Ndërsa, procesi i muzealizimit është shqyrtuar në Këshillin Kombëtar të Muzeve, i cili është organ kolegjal vendimmarrës pranë Ministrisë së Kulturës.	E plote	JO
517/1	30.03.2021	Kerkese per dokumentacion ne lidhje me relacionet dhe projektet te lidhura te urave me risk te larte dhe materiali arkitektonik dhe relacion ne lidhje me xhamine e Shkozetit, Durres, “Riza Bajrami”.	12.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj Ju bëjmë me dije se objektet e mëposhtme: 1. Ura e Tapizës (Krujë); 2. Ura e Zemblakut (Korçë); 3. Ura e Kadhulit (Përmet); 4. Xhamia e Shkozetit , Durrës “Riza Barami”. nuk janë “pasuri kulturore”, prandaj nuk disponojmë dosje teknike për to. Objektet “Ura metalike e Leklit” dhe “Ura metalike e Dragotit” janë shpallur “monument kulture” me Urdher Nr. 236 nga MTKRS në vitin 2010. Sa më sipër, ne dosjen teknike të dy urave disponojmë vetëm projekt të vitit 2020 (projekt i cili mund të jepet vetëm me të drejtën e autorit në bazë të <i>Ligjit Nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”</i>).	E plote	JO
534	31.03.2021	Kerkohet dosja e plote e objektit nr, 210, kodi II-74 “Ish ATSH ne BLv. Zogu i I-re”, ne listen e	12.04.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: - Objekti është pasuri kulturore, monument kulture i kategorisë së II-të, shpallur me Urdhër të Ministrit Nr.122, datë 05.03.2007, me emërtimin “Ish ATSH në bulevardin “Zogu i Parë”;	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

		monumente te kultures ne Tirane, me Vendimin nr. 122 date 5.3.2007. A ka nje vendim dhe akt ekspertimi qe i heq statusin monument kulture ketij objekti? Nese po, kerkohet kopje e ketij akti dhe vendimarrjes shoqeruese.		- Ndërtesa është pjesë përbërëse e projektit “Rehabilitimi i Bulevardit Zogu i Parë”, miratuar me Vendim të KKR Nr.504, datë 26.12.2018. Ju informojmë se në IKTK nuk janë administruar akte ekspertize për deklarimin e mungesës së interesit kulturor për këtë objekt. Bashkëlidhur gjeni: - Urdhrin Nr.122, datë 05.03.2007; - Vendimin e KKR, Nr.504, datë 26.12.2018; - Fletë të projektit “Rehabilitimi i Bulevardit “Zogu i Parë”, Tiranë”, për objektin Nr.29; - Kartelën e pasurisë kulturore.		
538	31.03.2021	Kerkese per informacion lidhur me statusin e banesave/vilave ne rrugen “Kont Urani” .	16.04.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se ndodhen disa objekte pasuri kulturore me status “monument kulture të kategorisë së dytë”, si më poshtë: 1. Objekti me emërtimin në listën e pasurive kulturore “ <i>Tsh Pastërtia në "Rrugën e Kavajës" (kod II-101)</i> ”, shpallur me Urdhër Nr.122, datë 05.03.2007; 2. Objekti me emërtimin në listën e pasurive kulturore “ <i>Instituti i Kulturës Popullore në "Rruga e Kavajës" (kod II-102)</i> ”, shpallur me Urdhër Nr.122, datë 05.03.2007; 3. Objekti me emërtimin në listën e pasurive kulturore “ <i>Godinë zyra, shërbime, 3 kate; “Rruga e Durrësit” (kod II-146)</i> ”, shpallur me Urdhër Nr. 276, datë 16.07.2015; 4. Objekti me emërtimin në listën e pasurive kulturore “ <i>Banesë tip vilë, 2 kate; Rruga “Kont Urani” (kod II-150)</i> ”, shpallur me Urdhër Nr. 276, datë 16.07.2015; 5. Objekti me emërtimin në listën e pasurive kulturore “ <i>Banesë tip vilë, 2 kate; Rruga “Kont Urani” (kod II-151)</i> ”, shpallur me Urdhër Nr. 276, datë 16.07.2015. Bazuar në dokumentacionin e administruar në IKTK dhe shqyrtuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), tre objekte kanë humbur statusin mbrojtës për mungesë të interesit kulturor, si më poshtë: 1. Banesë tip vilë 2 kate me kod (II-143), humbur statusin në vitin 2017; 2. Banesë tip vilë 2 kate me kod (II-144), humbur statusin në vitin 2019; 3. Banesë tip vilë 2 kate me kod (II-149), humbur statusin në vitin 2020. IKTK nuk disponon informacion në lidhje me planet për prishjen/ rinovimin e objekteve të sipërcituara të cilat kanë humbur status mbrojtjeje sipas dispozitave të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si dhe të opinionit të banorëve për planet e mundshme për këto objekte. Bashkëlidhur gjeni fragment të hartës më njollat e objekteve “pasuri kulturore” në rrugën “Kont Urani”.	E plote	JO
571	02.04.2021	Kerkese per informacion ne lagjen Kala, Berat .	23.04.2021	Në vijim të kërkesës, Ju bëjmë me dije se: Kjo banesë është pasuri kulturore me status monument kulture i kategorisë së II-të, shpallur me Urdhër Nr. 147, datë 17.04.2015 me emërtimin “Banesa e Rajmonda Lolit Dhe Eleni Nanos (K 009)” dhe mbrohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Bashkëlidhur gjeni kartelën e pasurisë kulturore dhe materialin arkivor.	E plote	JO
584	01.04.2021	Shkrese percjellese nga MK per informacion per Mesonjetoren e Korces.		Riderguar ne MK lidhet me shkresen nr Prot. 505 . dt.24.03.2021	Deleguar	JO
591	07.04.2021	Kerkese per materiale arkivore per Xhamine e Plumbit	14.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se në arkivin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore nuk kemi informacion për materialet ekzistuese apo prova të kryera në terren për objektin “Xhamia e Plumbit”, Shkodër.	E plote	JO
592	07.04.2021	Kerkeseper informacion lidhur me banesen per ta futur ne listen e Monumenteve te Kultures, deleguar nga MK	23.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj , Ju bëjmë me dije se: Kjo banesë është pasuri kulturore me status monument kulture i kategorisë së I-rë, shpallur me Urdhër Nr. 266/1, datë 16.02.1979 me emërtimin “Banesa e Alush Myrtos” dhe mbrohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Bashkëlidhur gjeni kartelën e pasurisë kulturore.	E plote	JO
605	08.04.2021	Kerkese per kopje te dokumentacionit per “Akademine e Shkencave “	14.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj , Ju bëjmë me dije se: Ne arkivin Teknik, ne dosjen teknike te objektit “ Akademia e Shkencave “, monument Kulture kategoria e I-re, ne qytetin e Tiranës, nuk disponojme planimetri te godines.	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

609	08.04.2021	Kerkese per material per banesen muze te Aleksander Moisiut ne Durres .	13.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link, dokumentacionin arkivor grafik dhe përshkrimor (të viteve ‘80-të shek XX), për objektin me kod Nr. 284 “Banesa e Aleksandër Moisiu”, Durrës. . me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-BTnLA70t9W Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
611	09.04.2021	Kerkese per informacion mbi banesen ku jeton Isuf Isufaj ne fshatin Petkaj, komuna Malzi, Kukes .	30.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Në fshatin Petkaj, njësia administrative Malzi me vendndodhje në Kukës, nuk figuron asnjë pasuri kulturore me emërtimin “Kulla e Sali Agës” apo “Kulla e Tahir Agës”, të deklaruar sipas dispozitave të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Sa më sipër, IKTK nuk disponon asnjë informacion në lidhje me këtë objekt.	E plote	JO
631	13.04.2021	Kerkese per informacion mbi statusin e objektit “Shtëpia e qendistares se flamurit te Pavaresise Marigo Bozio” , ne lagjen Muradie te Vlores.	23.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Objekti “Shtëpia e qendistares së flamurit të Pavarësisë Marigo Bozio” në lagjen Muradie, Vlorë nuk ka status të veçantë mbrojtës, por është pjesë e Ansamblit Historik Urban “Justin Godard”, shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 01.07.1980. Gjithashtu, Ju informojmë se IKTK ofron shërbimin online “Vërtetim nëse prona/at e individëve apo subjekteve kanë ose jo status pasuri kulturore materiale” , ku çdo individ mund ta aksesojë nëpërmjet platformës E-Albania. Bashkëlidhur gjeni planvendosjen e objektit ne lidhje me rrugën “Justin Godard”.	E plote	JO
632	13.04.2021	Kerkese per nderhyrje ne banesat e vjetra ne fshatin Dardhe, Korce.	23.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Në fshatin Dardhë, në Korçë, kemi tre objekte pasuri kulturore, si më poshtë: · Kisha e Shën Gjergjit, në fshatin Dardhë, shpallur me Urdhër Nr. 1886, datë 10.06.1973; · Banesa e Ollga Pazes, në fshatin Dardhë, shpallur me Urdhër Nr. 348, datë 31.09.2009; · Shkolla Shqipe, në fshatin Dardhë, shpallur me Urdhër Nr. 528, datë 13.08.2018. Në vijim, për të gjykuar mbi kërkesën e Z.Thimo nevojitet informacion në lidhje me vendodhjen e saktë dhe foto të këtyre objekteve.	E plote	JO
517/2	14.04.2021	Kerkese per informacion per Xhamine e Plumbit ne Berat	19.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj Ju dërgojmë në link dokumentacionin arkivor të viteve ‘80-të për objektin “Xhamia e Plumbit”, në qytetin e Beratit si (grafik, relacion dhe fotot te vjetra) , me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-ohEWjI6asc Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
656	16.04.2021	Kerkese per materiale nga arkiva per disa objekte .	21.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor (grafik, fotografik dhe përshkrimor) për objektin “Kisha e Manastirit të Shën Qirjakut dhe Julitës”, Dhuvjan, Dropull, Gjirokastrë. , me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-tqtN6gInzD Ju bëjmë me dije se për tre objektet e tjera nuk disponojmë dokumentacion arkivor. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
665	19.04.2021	Kerkese per informacion lidhur me statusin e zones ne te cilen ndodhet banesa.	18.05.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Banesa ndodhet brenda zonës mbrojtëse të objektit pasuri kulturore “Bazilika Paleokristiane në Gjurica”, monument kulture i kategorisë së parë, shpallur me Urdhër Nr. 194, datë 21.04.2006. Në mbështetje të pikave 1 dhe 2 të Nenit 77 të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre, kryhet vetëm pas miratimit nga ana e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale pranë Ministrisë së Kulturës, dhe të Nenit 72 "Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licensuara për këtë qëllim ...”. Në zbatim të Urdhrit Nr. 729, datë 18.12.2019 "Për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 153 datë 21.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020", të gjitha aplikimet bëhen vetëm nëpërmjet portalit E-albania. Në vijim, dokumentacioni i nevojshëm për projektin që kërkohet gjatë fazave të aplikimit online, në mënyrë të përmblodhur është: 1. Projektet teknike dhe relacionet përkatëse, në format pdf dhe të nënshkruara nga person fizik/juridik i licensuar në restaurim; (Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhurnuar të hartës së parcelës; Vendndodhja me koordinata gjeografike; Ortofoto; Specifikime Teknike); 2. Grafiku i punimeve; 3. Preventiv; 4. Prezantim projekti në format Powerpoint;	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				5. Projekti i plotë në format të editueshëm (AutoCAD, Revit, Archicad, etj). Ndërhyrjet në pasuri kulturore ose brenda kufirit të zonave mbrojtëse të pasurive kulturore, shqyrtohen fillimisht në Këshillin Teknik dhe më pas në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë e Kulturës.		
690	19.04.2021	Kerkese per material nga arkiva, Kisha e Shen Marise, Kameno, Delvine.	21.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor (grafik, fotografik dhe përshkrimor) për objektin “Kisha e Manastirit të Shën Mërisë”, Kameno, Delvinë. , me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-w784j1Ce8d Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
703	22.04.2021	Kerkese per dokumentacion grafik per 2 banesa ne Tirane.	23.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor (grafik, fotografik dhe përshkrimor) për objektet: 1. Banesa e Abdulla Ketës, Tiranë; 2. Banesa e Hysen Kazanit, Tiranë. me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-RbtCpQiNhC Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
732	27.04.2021	Kerkese per informacion ne formatin vektorial (GIS) per Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Kultures te perditesuara.	05.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur ne link materialet e kerkuara ne formatin vektorial (GIS), me kod arkivi Nr.-, https://we.tl/t-1ntRRQJRqO	E plote	JO
739	27.04.2021	Kerkese per material arkivor per objektin “Kisha e Manastirit të Shën Mërisë”, Dhërmi, Himare	10.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link materialin arkivor për objektin “Kisha e Manastirit të Shën Mërisë”, Dhërmi, Himare si më poshtë, me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-Ocxu0CDPvu - Dokumentacion grafik në arkitekture dhe art; - Dokumentacion fotografik; - Dokumentacion përshkrimor. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
750	29.04.2021	Kerkese per materiale per Ish Hetuesia Vlore	05.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se në arkivin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore nuk disponojmë dokumentacion teknik, grafik, pershkrimor apo fotografik për objektin “Ish Hetuesia”, në qytetin e Vlorës.	E plote	JO
754	29.04.2021	Kerkese per informacion, materiale per Kishen e Shen Premte, Hoxhare Fier .	12.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor (grafik, fotografik dhe përshkrimor) për objektet: Teatri i Apollonisë, Kisha “Shën e Premte”, në fshatin Sop, Fier, me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-6kVSL8IYhU Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK). Ju bëjmë me dije se nuk disponojmë për shpërndarje kopje të librit “Historia e Arkitekturës në Shqipëri”.	E plote	JO
758	30.04.2021	Kerkese per ndihme per te hyre ne ne proces te dokumentacioneve ne lidhje me aspektin arkitektonik si planimetri, pamje , prerje, relacione ne lidhje me Amfiteatrin e Durrësit .	11.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link materialin arkivor per objektin “Amfiteatri i Durrësit”, me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-70yt4OnyCB - Dokumentacion grafik (planimetri, prerje, pamje); - Dokumentacion përshkrimor. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
769	04.05.2021	Kerkese per informacion ne lidhje me monumentet e demtuara nga termeti i Nentor 2019 .	06.05.2021	Në vijim të kërkesës, Ju bëjmë me dije se: Nga tërmeti i Nëntorit 2019 rezultojnë të jenë dëmtuar 35 objekte me status “Pasuri Kulturore”, të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Përsa i përket ndërhyrjeve për përfortim strukture dhe restaurim, janë në proces zbatimi 4 (katër) projekte: - Kalaja e Durrësit (Kulla C); - Kulla në Kalanë e Prezës; - Teqja e Dollmës në Kalanë e Krujës; - Mozaiku në fasadën kryesore të Muzeut Historik Kombëtar. Procesi i rimëkëmbjes së trashëgimisë kulturore ka filluar në Dhjetor 2019 dhe ende nuk është finalizuar zbatimi i të gjithë projekteve të hartuara për ndërhyrje në pasuritë kulturore. Sa më sipër, finalizimi i zbatimit të projekteve përkatëse do të përcaktojë vlerën totale të ndërhyrjeve.	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

771	05.05.2021	Kerkese per informacion ne lidhje me transport pikturash .	05.05.2021	Ne vijim te emailit per trajtim te kerkeses se Znj. -, ju bejme me dije se: Bazuar ne Ligjin nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete" neni 29-30 objekti i kerkeses ne fjale nuk eshte ne kompetencen e Institutit Kombetar te Trashegimise Kulturore per trajtim.	E plote	JO
774	06.05.2021	Kerkese per informacion per “Senatoriumi i Korces”	18.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se në Arkivin teknik nuk disponojmë dokumentacion per objektin “Senatoriumi i Korçës” (Spitali Th. Turtulli).	E plote	JO
776	06.05.2021	Kerkese per materiale nga arkiva per Kisha, Xhamia ne Kalane e Shkodres dhe Memoriali i Skenderbeut ne Lezhe.	20.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion materialin arkivor për objektet “Kisha/ xhamia në Kalanë e Shkodrës” dhe “Memoriali i Skenderbeut (Kisha e Shën Nikollës)”, Lezhë si më poshtë, me kod arkivi Nr. -: - dokumentacion të vjetër grafik; - relacion teknik; - foto historike. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet: https://we.tl/t-mNeuQwtNN2 Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
777	06.05.2021	Kerkese per materiale nga arkiva per disa objekte .	18.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion materialin arkivor për objektet : 1- “Kisha e Manastirit të Shën Mërisë ”, Kamenoi, Delvinë si më poshtë: - Dokumentacion grafik; - Dokumentacion fotografik; - Dokumentacion përshkrimor. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet , me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-ZPaUWMsdeX , 2- “Teatri antik i Apollonisë ”, si më poshtë: - Dokumentacion grafik; - Dokumentacion fotografik; - Dokumentacion përshkrimor. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet , me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-TZSuIKtlfV 3- Për objektin “Tsh Senatoriumi”, Korçë, ju bëjmë me dije se në arkivin teknik të IKTK-së nuk disponojmë dokumentacion grafik, përshkrimor apo fotografik . 4- Për objektin “Kullat e Dervish Aliut ”, Dukat, Vlorë si më poshtë: - Dokumentacion grafik; - Dokumentacion fotografik; - Dokumentacion përshkrimor. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet, me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-SvLMC6hOMF 5- Për objektin “Pazarin e Bilishtit” si më poshtë: - Propozim i vitit 2007 per venien ne mbrojtje te pazarit; - Relacion. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet., me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-3NUbspSRps 6- Për objektin “Kisha e Manastirit të Shën Mërisë së Krimeanovës në Pigeras”, Lukovë: dokumentacion grafik, përshkrimor dhe foto historike. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet., me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-tc6DyXdwYe 7-Për objektin “Manastiri Shën Qirjakut dhe Julitës”, në fshatin Dhuvjan, Dropull si më poshtë: - Dokumentacion grafik (planimetri, pamje, prerje); - Relacione teknike; - Foto historike. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet., me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-9zn1KPIOd4 8-Për banesat e Malësisë së Gjakovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, Ju bëjmë me dije se nuk disponojmë dokumentacion arkivor. Lidhur me objektet e Tropojës, lutem mund te na specifikoni banesën që keni për studim. 9-Lidhur me banesat matjane, lutem mund te na specifikoni objektet që keni për studim. Jemi në pritje, me qëllim dërgimin e materialit specifik. 10-Në vijim të kërkesës Suaj, per disa nga banesat matjane si më poshtë: · Banesa e Rexhep Lleshit në fshatin Klos-Katund; · Banesa e Rexhep Karait ne fshatin Dars;	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				· Banesa e Bajram Allushit në fshatin Klos-Katund; · Banesa e Hysen Dodollit në fshatin Benjë; · Banesa e Jakup Kurtit në fshatin Plan i Bardhë; · Kulla e Sul Lëkursit në fshatin Gur e Bardhë; · Banesa e Asllan Hutës në fshatin Plan i Bardhë. Ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin Teknik., me kod arkivi Nr. -. https://we.tl/t-o49g2LOC6A 11-Në vijim të kërkesës Suaj, per disa nga banesat e Tropojës si më poshtë: - Banesa e Adem Demaj, ne fshatin Papaj; - Banesa e Bajram Osmanit ne fshatin Shoshan; - Banesa e Halil Çeleposhit ne fshatin Babinë; - Banesa e Ismail e Arif Mustafait ne qytetin e Bajram Currit; - Banesa e Sali Mani (Bujan); - Banesa e Mehmet Ramës ne fshatin Kocanaj; - Kulla e patriotit Mic Sokoli ne fshatin Bujan. Ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin teknik., me kod arkivi Nr. -. https://we.tl/t-9pVlpDrFpq Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).		
781	06.05.2021	Kerkese per informacion per banesen e Bajram Xhanit, Kavaje.	18.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se në Arkivin teknik nuk disponojmë dokumentacion per objektin “Banesa e Bajram Xhanit” në qytetin e Kavajës. Per objektin “Instituti i Kulturës Popullore”, në rrugën e “Kavajës”, në qytetin e Tiranës (Ish Radio Tërana), Ju bëjmë me dije se në Arkivin teknik nuk disponojmë dokumentacion.	E plote	JO
782	06.05.2021	Kerkese per informacion per Manastirin e Shen Merise, Dhermi.	18.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion materialin arkivor për objektin “Kisha e Manastirit të Shën Mërisë”, Dhermi si më poshtë: - Dokumentacion grafik në arkitekture dhe art; - Dokumentacion fotografik; - Dokumentacion përshkrimor. Bashkelidhur gjeni linkun me materialet, me kod arkivi Nr. -. https://we.tl/t-ZuclDUDLss Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
822	12.05.2021	Kerkese per hartim projekti dhe ndryshim emertimi per banesen e Faik Belaj ne Gjirokastrer.	24.05.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, lidhur me emërtimin e banesës me status pasuri kulturore në qytetin e Gjirokastrës, me emërtimin “Banesa e Faik Belaj dhe Vasil Papadhopullit, lagjja “Partizani”, Rruga “S. Musaj”, Nr.10, në qytetin e Gjirokastrës”, shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me Nr.1886, datë 10.06.1973, Ju bëjmë me dije se: Gjatë procesit të rishikimit dhe përditësimit të listave të pasurive kulturore në qytetin e Gjirokastrës, të kryer në vitin 2016 nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Gjirokastrë, për secilin objekt që gëzonte këtë status mbrojtjeje sipas dispozitave të legjislacionit për trashëgiminë kulturore në fuqi, është vendosur 1 kod unik i cili mundëson identifikimin e objektit në listë dhe në hartë, pavarësisht transaksioneve të mundshme të drejtës së pronësisë. Përsa më sipër, pasuria kulturore “Banesa e Faik Belaj dhe Vasil Papadhopullit, lagjja “Partizani”, Rruga “S. Musaj”, Nr.10, në qytetin e Gjirokastrës” identifikohet me kodin unik 109004, në listën e pasurive kulturore dhe në hartën e qytetit të Gjirokastrës.	E plote	JO
822/3	02.06.2021	Kerkese per informacion si dhe materialet e njehsuara me originalin per banesen e “Faik Belaj”	15.06.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, lidhur me informacionin për objektin pasuri kulturore, në qytetin e Gjirokastrës, Ju bëjmë me dije se: Objekti pasuri kulturore “Banesa e Faik Belaj dhe Vasil Papadhopullit, lagjja “Partizani”, Rruga “S. Musaj”, Nr.10, në qytetin e Gjirokastrës” është shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë, nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me Nr.1886, datë 10.06.1973. Për sa i përket kërkesës për të reflektuar në emërtimin e objektit pasuri kulturore emrat sipas dokumentave të pronësisë, Ju informojmë se emërtimi i objekteve pasuri kulturore është i përcaktuar në Urdhrin e shpalljes dhe ruhet pavarësisht transaksioneve të mundshme të së drejtës së pronësisë. Lidhur me ndryshimin e statusit, me shkresë nr. 376 Prot., datë 2.06.1980, Instituti i Monumenteve të Kulturës i drejtohet Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës me kërkesën për rishikimin e kategorisë së monumentit. Me shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës nr.1925/1 Prot., datë 28.06.1980, drejtuar Institutit të Monumenteve të Kulturës, miratohet kërkesa për ndryshimin e kategorisë për këtë objekt pasuri kulturore.	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				Bashkëlidhur gjeni: - Shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Nr. 1886, datë 10.06.1973, kapitulli VI – Rrethi i Gjirokastrës, pika 59 “Banesa e Faik Belaj dhe Vasil Papadhopullit, lagja “Partizani”, Rruga “S. Musaj”, Nr.10, në qytetin e Gjirokastrës”; - Shkresë nr. 376 Prot., datë 2.06.1980; - Shkresë nr.1925/1 Prot., datë 28.06.1980.		
822/5	18.06.2021	Kerkese per korigjim emertimi per emertimin e baneses monument kulture.	02.07.2021			
822/6	23.06.2021	Delegim kerkese nga MK lidhet me kerkesen nr Prot. 822/5.	7.7.2021			
851	18.05.2021	Delegim kerkese nga MK, per mbeshtetje financiare per banese Monument Kulture kategoria e I-re , ne Berat .	01.06.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se është hartuar dokumentacioni si më poshtë: -Proces-verbali i mbajtur në datë 17.05.2021, gjatë inspektimit të grupit të punës në objektin pasuri kulturore "Banesa e Neki Novës" Berat; -Relacioni mbi vëzhgimin në terren të gjendjes aktuale dhe përcaktimin e një vlerësimi paraprak për dëmin në objekt; -Preventivi paraprak për vlerën e dëmeve të shkaktuara në këtë objekt nga zjarri. -Lidhur me statusin juridik të pronës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore nuk ka informacion mbi çështjet e pronësisë. Në vijim, në rastin e hartimit të një projekti restaurimi për këtë objekt, dokumentacioni duhet të shqyrtohet fillimisht në Këshillin Teknik dhe më pas në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë e Kulturës. Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin e sipërcituar.	E plote	JO
853	18.05.2021	Kerkese per informacion per objektin Monument Kulture “ Tyrbja e Nuses “	28.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, ju dërgojmë bashkëlidhur ne link kopje të dokumentacionit arkivor grafik, pershkrimor dhe fotografik për objektin “Tyrbja e Nuses”, në fshatin Mullet, Petrelë, Tiranë, me kod Nr. 1721, me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-Duz0ylNn4l Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
864	19.05.2021	Kerkese per informacion per Kishen e Shen Kollit, Voskopoje .	02.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik dhe pershkrimor për objektin me kod Nr. 893 "Kisha e Shën Kollit", në Voskopoje, Korçë, me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-NzovDkbIvO Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur të citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
904	26.05.2021	Kerkese per materiale per banesen e Sali Bajram Zekes ne Lezhe	08.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik dhe pershkrimor për objektin me kod Nr. 1189 "Banesa e Sali Bajram Zekës", në qytetin e Lezhës. me kod arkivi Nr. - https://we.tl/t-dAqASYFB9s Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
905	26.05.2021	Kerkese per informacion per problematiken e baneses “Bekteshi” .	31.05.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, lidhur me problematikën në afërsi të banesës pasuri kulturore , monument kulture i kategorisë së I - rë me emërtimin “ Banesa e Ramiz Bekteshit ” në Shkodër , Ju bëjmë me dije se : Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër , me shkresën Nr . 145/1 Prot . , datë 26.05.2021 , administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr . 923 Prot . , datë 28.05.2021 i përcjell Z. Besnik Kurtbegu kërkesën për pezullim punimesh për ndërhyrjet e sistemit dhe shtrimit të oborrit , ndërhyrje e cila çënon çatinë e banesës monument kulture i kategorisë së I - rë “ Banesa e Ramiz Bekteshit . Bashkëlidhur gjeni kopje të shkresës të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore , Shkodër .	E plote	JO
912	26.05.2021	Kerkese per informacion dhe venie ne dispozicion te dokumentacioneve .	06.04.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : Në mbështetje të nenit 47, të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar (ligji në fuqi në kohën e miratimit të projektit), në Institutin e Monumenteve të Kulturës është dorëzuar për shqyrtim vetëm projekt zbatimi i HEC "Lingajcal " dhe "Lingajca 2" Kontratat dhe procesverbalet e konsultimeve me publikun dhe zhvendëtimin e komunitetit të zonës, marrëveshjet me Bashkinë, zbatimin e tyre dhe afatet kohore, nuk janë pjesë e procesit që nevojiten për shqyrtimin e projektit të sipërcituar dhe nuk administrohen në Institucionin tonë. Restaurimi i objektit "Kompleksi i shtatë qezmave të Moisi Golemit, Bërzësht", monument kulture kategoria e I-rë, i vendosur në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimit Nr. 14, datë 10.01.2018, është në vlerësimin e investitorit si formë kontributi vullnetar për trashëgiminë kulturore. Bashkëlidhur gjeni materialet e depozituara në forme elektronikë me kod arkivi Nr.- https://we.tl/t-8PDh0hI8M7	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).		
940	31.05.2021	Kerkese per materiale grafike per banesen Nr.38, Lagjia 3, Korce	11.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se në arkivin teknik të IKTK-së nuk disponojmë dosje teknike për objektin Nr. 38 (banesë), në migjen "Mihal Grameno", lagjia 3, në qytetin e Korçës.	E plote	JO
944	31.05.2021	Kerkese per informacion mbi objektet pasuri kulturore te demtuara nga termeti i nentorit 2019 ne Durres , percjelle nga MK	03.06.2021	Në vijim të shkresës, Ju bëjmë me dije se: Nga tërmeti i Nëntorit 2019 janë dëmtuar disa objekte me status "Pasuri Kulturore" në Durrës, të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Tipologjia e dëmtimeve në to përmbledhet në: dëmtime në strukturë, shpërbërje fragmentesh të strukturës dhe dëmtime në elementë jo-konstruktivë. Objektet pasuri kulturore që kanë pësuar dëmtime janë: -Banesa ku lindi dhe kaloi disa vite të fëmijërisë Aleksandër Moisiu; -Kalaja e Durrësit (Kulla "C" dhe muret e fortifikimit); - Amfiteatri ; -Kalaja e Ishmit dhe banesa pranë mureve të kalasë; -Muret e portës (Porto Romano); -Hamami në oborfin e Shkollës "16 Shtatori"; -Kalaja e Currilave në Muzhlin e Skënderbeut, Kepi i Rodonit; -Rrënojat e Kishës së Shën Ndojit në Muzhlin e Skënderbeut, Kepi i Rodonit. Në objektin pasuri kulturore "Kalaja e Durrësit - Kulla C" ka nisur implementimi i ndërhyrjeve restauruese, ndërsa për objektet e tjera pasuri kulturore është në proces finalizimi i procedurave për nisjen e ndërhyrjeve. Përsa më sipër, përfundimi i zbatimit të projekteve të restaurimit në këto objekte do të përcaktojë vlerën totale të ndërhyrjeve.	E plote	JO
961	02.06.2021	Kerkese per informacion per banesen e Haxhi Alushit	11.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik, fotografik dhe përkshkrimor për objektin me kod Nr.2681 "Banesa e Haxhiallushëve", në qytetin e Kavajës, si dhe dokumentacion grafik për objektin me kod Nr. 1807 "1sh banesa e Toptanasve", në qytetin e Tiranës. Bashkëlidhur gjeni materialet e depozituara në formë elektronike me kod arkivi Nr.- https://we.tl/t-yAYBEyPB6T https://we.tl/t-Ep6MNs7RKH Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
967	02.06.2021	Kerkese per informacion lidhur me ngrijten e grupit te punes per demet ne Uren e Zogut .	14.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër (DRTK Shkodër) kanë ngritur grupin e punës për ndjekjen e situatës. Si një vepër inxhinierike e cila kërkon ndërhyrje të specializuara, IKTK ka dërguar disa shkresa bashkëpunimi për hartimin e projektit inxhinierik, përkatësisht drejtuar Autoritetit Rrugor Shqiptar, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, Ministrisë së Mjedisit dhe Institutit të Ndërtimit. Instituti i Ndërtimit me shkresë Nr.202/1 Prot., datë 09.02.2021, administruar në IKTK me Nr. 188/1 Prot., datë 11.02.2021 ka komunikuar se në bashkëpunim me ARRSH-në do të hartojë projektin e ndërhyrjeve shpëtuese që duhen bërë në Urën e Matit. Për sa më sipër, jemi në pritje të hartimit të projektit nga ana e Institutit të Ndërtimit për të vazhduar me procedurat e shqyrtimit deri në miratim të tij pranë organeve përkatëse në Ministrinë e Kulturës.	E plote	JO
1005	09.06.2021	Kerkese per informacion/dokumentacion per objektin ne Rr."Gjuhadol", Shkoder.	15.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor, grafik dhe përkshkrimor për objektin "Njësi tregtaro-banimit", në ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rugës "Gjuhadol", në qytetin e Shkodrës. Bashkëlidhur gjeni materialet e depozituara në formë elektronike me kod arkivi Nr.- https://we.tl/t-05lccFS1Gw Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
1039/1	18.06.2021	Kerkese per informacion per Kullen e Gjon Markagjonit ne Shkoder.	23.06.2021	Në vijim të kërkesave Tuaja, në lidhje me informacionin për objektin "pasuri kulturore", me emërtimin "Kulla e Gjon Marka Gjonit" Shkodër, Ju bëjmë me dije se: Objekti mban statusin pasuri kulturore, monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Vendim Nr.6, datë 15.01.1963, të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, pika 27, "Shtëpia banimi (pasuri shteti) ish Kulla e Gjon Markut, lagjia 1 Maj, Nr.15, në qytetin e Shkodrës" dhe Shkresë Nr. 1886, datë 10.06.1973, të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, pika 28, "Banesa (pasuri shteti) ish-kullë e Gjon Marka Gjonit, lagjia 1 Maj, Nr.15, në qytetin e Shkodrës". Si i tillë, ky objekt mbrohet sipas dispozitave të ligjit Nr.27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Sipas vendimeve të lartpërmendura rezultojnë se objekti ishte pronë shtetërore në periudhën kur i është dhënë statusi i mbrojtjes "Monument Kulture".	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL – QERSHOR 2021

				Në zbatim të ligjit Nr. 27/2018, verikimi i interesit kulturor kryhet sipas neneve të Kreut II, Verifikimi dhe Deklarimi i Interesit Kulturor dhe Regjistrimi i Pasurisë Kulurore. Gjithashtu, sipas Nenit 32, pika 4, lëshimi i çertifikatës së regjistrimit të pasurisë kulturore është kompetencë e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulurore. Në lidhje me këtë objekt pasuri kulurore, në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulurore është përcjellë nga Ministria e Kulturës, kërkesa e datës 19.09.2019 e Znj. Brigjilda Markagjonaj për restaurimin e çatisë së ndërtesës. Me shkresë Nr. 1891/3 Prot. datë 26.09.2019, është kërkuar nga DRTK Shkodër kryerja e verifikimit në vend të objektit, si dhe hartimi i projektit për ndërhyrje, i cili është miratuar në KKTKM me Vendim Nr.8, datë 07.01.2020. Sa më sipër, po ju përcjellim vendimet e shpalljes dhe dokumentacionin arkivor përkatës.		
1046	15.06.2021	Ankese/kerkese lidhur me pezullimin e punimeve te Z.B Kurtbegu	24.06.2021	Në vijim të kërkesës së Z. Besnik Kurtbegu, jemi informuar për problematikën në banesën në pronësi të Z. Besnik Kurtbegu, Lagjja “Vojo Kushi”, Rr. “Lek Dukagjini”, Shkodër. Për sa më sipër, kërkohet nga ana Juaj një vlerësim në terren i gjendjes së objektit dhe hartimi i një relacioni të detajuar, i cili do të përcillet pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulurore. Bashkëlidhur gjeni kopje të kërkesës së Z. Besnik Kurtbegu.	E plote	JO
1053	16.06.2021	Kerkese per material nga arkivi per monumentet ne qytetin e Shkodres.	23.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik dhe përshkrimor, që lidhen me "Ansamblin arkitektoniko-urbanistik" të rrugës "Gjuhador", Shkodër dhe dokumentacion përshkrimor (relacione - teknike të viteve 80-të shek. XX) për objektin ' 'Kafja e Madhe" në qytetin e Shkodrës . Bashkëlidhur gjeni materialet e depozituara në forme elektronikë me kod arkivi Nr.- https://we.tl/t-9IYyHs6RuY Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
1071	21.06.2021	Kerkese per materiale arkivore per banesen e Koco Cucit ne Dhoskat.	23.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik, fotografik dhe përshkrimor për objektin me kod Nr. 3575 "Banesa e Koço Çuçit", në fshatin Dhoksat, Gjirokastrë. Bashkëlidhur gjeni materialet e depozituara në forme elektronikë me kod arkivi Nr.- https://we.tl/t-CrMrxLdxvV Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
1091	22.06.2021	Kerkese per informacion / materiale per projektin e godines se Galerise Kombetare te Arteve .	29.06.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të projektit mbi ndërhyrjet që janë parashikuar të kryhen në godinën e "Galerisë Kombëtare të Arteve" në funksion të restaurimit e rehabilitimit të tij dhe adaptimit të një volumi të ri në fasadën e pasme, Ju bëjmë me dije se: Në baze të Ligjit Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me t' dhe nenit 17, pika 1 germa c) te Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", projekti me objekt "Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombetar te Arteve te Bukura "Galeria Kombetare e Arteve ", në qytetin e Tiranës është subjekt i mbrojtjes se te drejtës së autorit.	E plote	JO
1093	22.06.2021	Delegim kerkese/ankese nga MK per pronen ne Shkoder.	6.7.2021			